



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr 01-112/01-18146

Datë 11.09.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 68 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me datë 11.09.2023 merr këtë:

**V E N D I M**

1. Formohet Komisioni i Përzgjedhjes për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për grupin *Specialistë të Arsimit*, sipas konkursit me numër 01-111/01-18117 të datës 08.09.2023.
2. Komisionin e Përzgjedhjes nga pika 1 e këtij vendimi e përbëjnë:
  - 2.1. Bajram Salihi – Kryesues
  - 2.2. Jeta Haraçia – Anëtare
  - 2.3. Zymber Berisha – Anëtarë
  - 2.4. Kastriot Sada – Anëtarë
  - 2.5. Mergim Delija – Anëtarë
3. Komisioni i Përzgjedhjes, ka për detyrë dhe përgjegjësi që të bëjë vlerësimin e kandidatëve që i nënshtrohen procedurave të vlerësimit nëpërmjet testimit me shkrim dhe të intervistës me gojë, për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. Komisioni pas përfundimit të procedurës së rekrutimit shpërbëhet menjëherë.

**A r s y e t i m**

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 68 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me qëllim të respektimit të procedurave ligjore të përcaktuara me ligjet në fuqi lidhur me rekrutimin e kandidatëve që kanë aplikuar në grupin *Specialistë të Arsimit*, sipas konkursit me numër 01-111/01-18117 të datës 08.09.2023, u caktua komisioni që të bëjë vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve.

Bazuar në atë që u tha me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Vendimi iu dorëzohet:**

- Komisionit të Përzgjedhjes
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës